VENDIM
Nr.59, datë 29.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të nenit 53 pika 4 të shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 55, të nenit 56 pika 2, neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet udhëzimi "Mbi transparencën e operacioneve dhe shërbimeve bankare", i miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.49, datë 22.4.1999 dhe neni 22/1 i rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.52, datë 14.7.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE
(Miratuar me vendimin nr. 59.datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët mbi produktet dhe shërbimet bankare e financiare të ofruara nga subjektet e kësaj rregulloreje, me qëllim sigurimin e transparencës dhe mbrojtjen e klientit.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet financiare jobanka (më poshtë për thjeshtësi do t'i referohemi me termin "banka"), të cilat

ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji "Për bankën") dhe të nenit 53 pika 4, të shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56 pika 2, të neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji "Për bankat").

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit "Për bankat".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Normë efektive e interesit" (NEI) - është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) "Kostoja totale e kredisë për klientin" është tërësia e të gjitha shpenzimeve, duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan në lidhje me marrëveshjen e kredisë sipas kushteve të saj (shpenzimet për shërbimet ndihmëse për marrëveshjen e kredisë, në veçanti primet e sigurimit, përfshihen nëse shërbimi është i detyrueshëm për të përfituar kredinë ose normën e interesit të aplikuar).

KREU II
PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE

Neni 5
Kërkesa të përgjithshme

1. Bankat publikojnë:

a) afatet dhe kushtet e llogaritjes dhe të ndryshimit të normave të interesit për depozitat, për kreditë dhe komisionet për shërbimet e kryera;

b) metodologjinë e llogaritjes së interesave për depozitat dhe kreditë; si dhe

c) kushtet dhe afatet e shlyerjes së kredive.

Publikimi i tyre bëhet edhe në faqen e bankave në internet.

2. Bankat sigurojnë që informacioni, afatet, kushtet e produkteve dhe shërbimeve, të drejtat dhe përgjegjësitë e klientit, të jenë të plota dhe të sakta, si dhe në një gjuhë të kuptueshme për klientin. Gjuha ligjore ose teknike, do të përdoret vetëm kur paraqitet e domosdoshme.

3. Përpara se klienti të zgjedhë një produkt ose shërbim, bankat i japin klientit paraprakisht informacion të plotë për kushtet, afatet dhe normat në përqindje të interesit, për rreziqet që shoqërojnë marrjen e produktit apo shërbimit, si dhe komisionet dhe gjobat (penalitetet), në rastet kur këto të fundit bëhen të aplikueshme etj.

4. Në rastet kur bankat ndryshojnë kushtet e kontratave dhe/ose të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare apo financiare, ato duhet të njoftojnë me shkrim dhe në mënyrë individuale, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve. Ky njoftim, duhet të kryhet përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Ai duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për klientin.

5. Përveç sa përcaktohet në pikën 4, bankat informojnë klientin/ët për ndryshimin e kushteve të kontratave dhe/ose të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare apo financiare, duke përdorur si mjet njoftimi një nga format vijuese: me shkrim, me mjetet elektronike të komunikimit, me afishimin e njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës, me mjetet e komunikimit masiv.

6. Bankat informojnë paraprakisht klientin, në rastin e përdorimit të kartave të debitit/*cash* dhe të kartave të kreditit, për kushtet e përdorimit dhe për komisionet e veprimeve që kryhen me kartë, në veçanti në ATM-të e bankës dhe ATM-të e bankave të tjera. Ky informacion afishohet për klientin pranë ATM-së, përveçse informimit në marrëveshjen (kontratën) e lidhur për këtë lloj shërbimi. Përmbajtja e njoftimit që do të vendoset pranë çdo ATM-je të bankës do të jetë sipas aneksit nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

7. Bankat u bëjnë të qartë klientëve të gjitha rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen në përdorimin e çdo produkti apo shërbimi që ato ofrojnë.

Neni 6

Metoda e llogaritjes dhe publikimi i normës efektive të interesit për kreditë

1. Norma efektive e interesit llogaritet sipas formulës matematike të paraqitur në aneksin nr.1 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të llogaritjes së normës efektive të interesit, totali i kostos së kredisë për klientin sipas nenit 4, pika b, nuk përfshin:

a) shpenzimet që nuk njihen në datën e llogaritjes, që mund të ndodhin gjatë disbursimit të kredisë;

b) shpenzimet e pagueshme nga klienti për moszbatimin e ndonjë prej angazhimeve të tij, të parashikuara në marrëveshjen e kredisë;

c) shpenzimet e tjera të ndryshme nga çmimi i blerjes, të cilat, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, klienti është i detyruar t'i paguajë nëse blerja është kryer me para në dorë ose me kredi me këste,me kusht që vetë banka të mos jetë përfituesi i fundit i këtyre pagesave;

d) kostot e pagueshme nga klienti, lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, një noter, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë;

e) shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë jo të detyrueshme;

f) çdo shpenzim që do t'i paguhet bankës nga klienti vetëm kur:

v) kredia në dispozicion nuk është përdorur në tërësi ose pjesërisht;

vi) klienti kërkon një ndryshim të afateve të pagesave dhe banka e pranon një kërkesë të tillë.

3. Shpenzimet e mbajtjes së një llogarie apo të përdorimit të një karte ose mjeti tjetër pagese për transaksionet e livrimit të kredisë dhe pagesës, si dhe kosto të tjera lidhur me transaksionet e pagesave në përgjithësi, do të përfshihen në koston totale të kredisë për klientin, nëse janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të veçantë në marrëveshjen e kredisë ose në ndonjë marrëveshje tjetër, të përfunduar me klientin.

4. Norma efektive e interesit llogaritet bazuar në supozimin që marrëveshja (kontrata) e kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord dhe palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në marrëveshjen (kontratën) e kredisë.

5. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë që përmbajnë dispozita, që lejojnë ndryshime në normat e interesit ose shpenzimet e tjera që përfshihen në normën efektive të interesit, por të pamatshme në kohën kur kjo normë llogaritet, norma efektive e interesit llogaritet duke supozuar që përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara (fikse), në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në fund të marrëveshjes së kredisë.

6. Banka duhet të parashikojë në kontratën e kredisë mënyrën e njoftimit të klientit në çdo rast të ndryshimit të elementeve bazë në llogaritjen e normave efektive të interesit, përpara se

të zbatojë këtë ndryshim.

7. Norma efektive e interesit publikohet duke përdorur termin “norma efektive e interesit ” ose shkurtimin “NEI”.

8. Banka publikon normën efektive të interesit në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë në ambientet e bankës.

9. Banka paraqet pranë Bankës së Shqipërisë raporte në baza tremujore mbi normat efektive të interesit, për të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve që ajo i ofron klientëve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas përfundimit të periudhës tremujore.

10. Banka e Shqipërisë mund të publikojë të dhënat mbi normat efektive të interesit, të raportuara nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Elemente të marrëveshjes (kontratës) së kredisë

1. Për çdo marrëdhënie kreditimi, banka dhe kredimarrësi nënshkruajnë një marrëveshje (kontratë) me shkrim, e cila minimalisht përfshin elementet e mëposhtme:

a) qëllimin e përdorimit të kredisë;

b) llojin e kredisë (me këste, kufi etj.);

c) kushtet e kredisë që lidhen me vlerën, njësinë monetare, datën e dhënies, datën e maturimit, normën nominale të interesit dhe llojin e saj (e ndryshueshme ose e pandryshueshme), indeksin orientues (norma e marrëveshjes së riblerjes e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, libor, euribor, tibor etj.), marzhin, normën efektive të interesit, frekuencën e ndryshimit të normës së interesit apo pjesëve përbërësë të saj, vlerën periodike të shlyerjes së kredisë (kësti) dhe datat ose periudhën e shlyerjes;

d) kontributin fillestar të kredimarrësit (nëse është e zbatueshme) ose komisione të ndryshme për marrjen dhe shlyerjen e kredisë;

e) llojin e kolateralit (nëse ka);

f) detyrimet dhe penalitetet e palëve dhe rastet kur ato lindin dhe zbatohen, veçanërisht kur subjekt i tyre është kredimarrësi;

g) mënyrën e ndryshimit të kushteve të kontratës;

h) mënyrën e përfundimit të kontratës;

i) numrin e kopjeve të nënshkruara në origjinal të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët.

2. Në procesin e livrimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, banka i ofron kredimarrësit:

a) planin e shlyerjeve të kredisë në momentin e livrimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;

b) planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëvazhdimit së saj;

c) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarresit dhe shembuj të mënyrës së llogaritjes së tyre;

d) një koment të shkruar, ku i tërhiqet vëmendja kredimarrësit për rrezikun që paraqet për të:

- huamarrja në valutë, veçanërisht në rastin kur të ardhurat e tij janë në lekë dhe mund të ketë lëvizje të pafavorshme të kursit të këmbimit lekë/valutë (ose e kundërta);

- rritja e normës së interesit të kredisë gjatë kohëvazhdimit së saj, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.

3. Në rastin e kredisë për konsum, përfshirë dhe kreditë për kartat e kreditit, ose në çdo formë tjetër kreditimi, në të cilin detyrimi i klientit ndaj bankës lind në formë automatike, kushtet e dhënies, të përdorimit dhe të kthimit të kredisë, së bashku me penalitetet përkatëse, duhet të

shprehen në mënyrë të plotë në kontratën që lidhet me kredimarrësin.

Neni 8

Informacione të veçanta lidhur me marrëveshjet (kontratat) e kredisë

1. Banka, në rast se norma e ndryshueshme e interesit është llogaritur nëpërmjet shtimit ose zbritjes të një marzhi fiks në përqindje apo nga një indeks publik i ndryshueshëm, i siguron me shkrim kredimarrësit të paktën një herë në 12 muaj, informacionin e mëposhtëm:

a) normën vjetore të interesit në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;

b) pjesën e papaguar të kredisë në fillim dhe në fund të periudhës përkatëse;

c) shumën e çdo kësti kredie, të përcaktuar sipas një plani pagesash dhe kohën kur duhet të paguhet çdo këst, bazuar në normën vjetore të interesit, të aplikuar në fund të periudhës përkatëse.

2. Banka, në rast se norma e interesit është llogaritur sipas një metode të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në një periudhë maksimalisht prej 30 ditëve pas rritjes së normës vjetore të interestit me më shumë se 1 % nga norma e fundit e interesit e aplikuar, i siguron me shkrim kredimarrësit informacionin e mëposhtëm:

a) normën e re të interesit dhe datën kur kjo normë bëhet e aplikueshme; dhe

b) shumën e çdo kësti kredie dhe kohën kur duhet të paguhet çdo këst, për pagesat që do të ndikohen nga norma e re vjetore e interesit.

3. Banka, në rastin e marrëveshjeve të financimit (linjave të kredisë), i siguron me shkrim kredimarrësit informacionin e mëposhtëm:

a) kufirin fillestar të kredisë, nëse është i njohur në momentin e dhënies së informacionit;

b) normën vjetore të interesit ose metodën e llogaritjes nëse është e ndryshueshme;

c) llojin dhe shumat e çdo pagese të ndryshme nga interesat;

d) pagesën minimale, gjatë çdo periudhe pagesash ose metodën e llogaritjes të saj;

e) çdo periudhë për të cilën do të jepet një gjendje e llogarisë;

f) datën kur dhe pas llogariten interesat dhe informacioni, në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;

g) të dhëna për komisionet dhe gjobat;

h) pasurin/të e luajtshme apo të paluetjshme, nëse ka, mbi të cilën/at banka siguron kredinë.

4. Bankat, në rastin e lëshimit të kartave të kreditit, përveç informacionit sipas shkronjave "a" dhe "c" të paragrafit 3 të këtij neni, japin dhe informacionin e mëposhtëm:

a) në rastin e kartave me:

i) normë fikse interesi, japin normën vjetore të interesit; ose

ii) normë të ndryshueshme të interesit, të llogaritur nëpërmjet shtimit ose zbritjes të një marzhi fiks në përqindje apo nga një indeks publik i ndryshueshëm, japin marzhin fiks në përqindje që i zbritet apo i shtohet dhe indeksin publik;

iii) mënyrën e llogaritjes së normës së interesit;

b) datën kur dhe pas të cilës, përllogariten interesat dhe informacion në lidhje me çdo periudhë faljesh të aplikueshme;

c) nëse kredimarrësit i kërkohet në marrëveshjen e kredisë të paguajë të gjithë pjesën e pashlyer të kredisë me marrjen e gjendjes së llogarisë, atij i jepet:

i) përshkrimi i këtij detyrimi;

ii) periudha e faljes, në fund të së cilës kredimarrësi duhet të paguajë pjesën e pashlyer të kredisë; dhe

iii) norma vjetore e interesit të aplikueshëm mbi pjesën e pashlyer të kredisë, e cila nuk është paguar në kohën e duhur.

d) Banka, në rast se merr një njoftim nga kredimarrësi, në formë të shkruar apo dhe gojore, për një kartë krediti të humbur apo të vjedhur, nuk krijon detyrimin për kredimarrësin që

ai të paguajë për transaksione të kryera me kartën e tij pas, bërjes së njoftimit.

Neni 9
Elemente të kontratës së llogarisë dhe depozitës

1. Për çdo llogari dhe depozitë të hapur nga klienti pranë bankës nënshkruhet një kontratë nga palët pjesëmarrëse në transaksion. Kontrata është një akt i veçantë, i ndryshëm nga dokumentet e aplikimit për hapjen e llogarisë.

2. Në kontratën e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit, përveç të dhënave personale të klientit dhe numrit të llogarisë, përfshihen detyrimisht:

a) norma e interesit dhe mënyra e llogaritjes së saj;

b) frekuenca e pagesave të interesit;

c) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat personale nga interesat;

d) komisionet për mirëmbajtjen e llogarive;

e) komisione apo gjoba të tjera të aplikueshme.

Elementet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" përfshihen në kontratë në rastet kur banka aplikon interes për llogarinë rrjedhëse dhe/ose llogarinë e kursimit.

3. Në kontatën e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të klientit, përfshihen:

a) shuma e investuar në depozitën me afat;

b) norma vjetore e interesit;

c) shumat e interesit dhe frekuenca e pagesës së tyre;

d) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;

e) data e maturimit të depozitës;

f) kushtet e zgjedhura nga klienti për rinovimin e depozitës me afat;

g) kushtet e anulimit (prishjes) të kontratës; dhe

h) penalitetet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës.

4. Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë dhe të depozitës mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar para se të aplikojë ndryshimin.

5. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të treguara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni të kontratës së llogarisë dhe/ose të depozitës, vetëm për një klient ose një grup të kufizuar klientësh, banka është e detyruar të njoftojë paraprakisht me shkrim klientin ose klientët. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të lartpërmendura të kontratës së llogarisë dhe/ose të depozitës, që prek në mënyrë të njëjtë të gjithë klientët si rrjedhojë e politikave të bankës, kjo e fundit është e detyruar të njoftojë paraprakisht secilin prej tyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

Neni 10
Marketingu

1. Banka siguron që materialet promocionale të produkteve apo shërbimeve bankare të jenë të vërteta, të sqarojnë në mënyrë të plotë të gjitha kushtet e ofrimit të produkteve dhe/ose shërbimeve, dhe të mos përfshijnë informacion të pasaktë apo që zmadhon së tepërmi, ose përpiqet të fshehë veçori të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

2. Në rastin e promovimit të karakteristikave preferenciale të shërbimeve (për shembull, normat e interesit), banka në të njëjtin promocion informon dhe mbi kushtet e veçanta të cilat duhen plotësuar për ta përfituar këtë shërbim.

3. Informacioni i përdorur për promocionin e produkteve dhe shërbimeve bankare bazohet në të dhëna të sakta, të verifikueshme, të hollësishme, në përputhje me parimin e mirëbesimit dhe të praktikave më të mira, me qëllim që t'i komunikojë publikut një informacion objektiv, të mjaftueshëm e të paanshëm.

Neni 11
Konfidencialiteti

1. Bankat ruajnë konfidencialitetin dhe/ose sekretin për të gjithë informacionin personal të klientit duke i garantuar këtij të fundit ruajtjen dhe administrimin e informacionit personal në sisteme të sigurta dhe të besueshme informacioni apo pagesash (transaksione, shërbime etj.).

2. Kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur:

a) banka detyrohet ta japë informacionin personal të klientit sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;

b) klienti kërkon me shkrim publikimin e këtij informacioni ose banka disponon lejen/autorizimin e tij me shkrim, për këtë qëllim.

3. Bankat i japin klientit, sipas kërkesës së tij, të gjithë informacionin e evidentuar për të.

4. Bankat janë të detyruara t'i japin klientit informacion bazë mbi depozitat e tij, të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Neni 12
Ankesat e klientëve

1. Bankat i sigurojnë klientit informacionin e nevojshëm mbi procedurat për trajtimin e ankesave në mënyrë të shpejtë dhe të plotë.

2. Në rastin e një ankese me shkrim nga klienti, banka duhet t'i japë përgjigje me shkrim klientit mbi ankesën, brenda afatit kohor të përcaktuar në aktet rregullative të bankës.

3. Banka është e detyruar të mbajë të dhëna për çdo ankesë të klientelës që ka lidhje me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, informacion mbi zgjidhjen e këtyre ankesave, si dhe të dhëna të tjera plotësuese të nevojshme.

4. Bankat evidentojnë në një regjistër të veçantë ankesat e klientit, si dhe hartojnë procedura dhe rregulla të brendshëm për trajtimin e tyre.

KREU III
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri 91 të ligjit "Për bankat" dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tij.

Neni 14
Dispozitë shfuqizuese

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk do të zbatohen për kreditë dhe/ose depozitat ndërbankare.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kreditë e miratuara dhe/ose depozitat e pranuara, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

ANEKSI NR.1

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDINË

Ekuacioni bazë, për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon, mbi një bazë vjetore, nga njëra anë vlerën totale faktike të kredisë (*total present value of drawns*, duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.), të vënë në dispozicion të klientit sipas marrëvëshjes së kredisë dhe në anën tjetër vlerën totale faktike (*total present value of repayments and payments of charges*) të shlyerjeve dhe/ose pagesave të shpenzimeve:

$$\sum_{k=1}^{m} Kk\,(1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} Rl\,(1+i)^{-tl}$$

Kuptimi i shkronjave dhe simboleve:

m - është numri total i kësteve të kredisë, nëse livrimi i kredisë bëhet me këste (*cash flow-ve*), të paguar nga kredidhënësi.

k - është numri në vazhdimësi për kështet e kredisë, nëse livrimi i kredisë bëhet me këste (*cash flow-t*), të paguara nga kredidhënësi (*drawn*), kështu që $1< k < m$ dhe/ose $1= k = m$.

Kk - është vlera faktike e kredisë (*cash flow*) së vënë në dispozicion të klientit në periudhën k.

tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së kështit të parë të kredisë (*first cash flow*) të vënë në dispozicion të klientit (nëse livrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t1 = 0$.

m' - është numri total i kësteve (*cash flow*-ve) të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

I - është numri në vazhdimësi i kësteve të paguara nga klienti (*cash flow*-ve) për shlyerjen e kredisë (shlyerja ose pagesa e shpenzimeve).

Rl - është vlera e kështit të shlyerjes (*cash flow*) ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l.

tl - intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së kështit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse livrimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së livrimit të kredisë, në rast se livrimi i kredisë bëhet i plotë (*first cash flow*) dhe datës së çdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.

i=NEI mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

Shënime:

a) Shumat e paguara nga të dyja palët në kohë të ndryshme nuk është e nevojshme të jenë të barabarta dhe të paguhen në intervale të barabarta.

b) Data e fillimit duhet të jetë ajo e pagimit të kështit të parë të livrimit të kredisë nga banka, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste ose e datës së livrimit të kredisë, në rast të livrimit të plotë të kredisë në dispozicion të klientit.

c) Intervalet midis datave të përdorura në llogaritjet duhet të shprehet në vite ose fraksione të vitit. Një vit presupozohet të ketë 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishtë, 52 javë ose 12 muaj. Një muaj presupozohet të ketë 30,41666 ditë (365/12) pavarësisht nëse është ose jo vit i brisht.

d) Rezultatet e llogaritjes duhet të shprehen me një saktësi, të paktën një vlerë pas presjes dhjetore.

e) Ekuacioni mund të rishkruhet duke përdorur një shumë të vetme në rast të livrimit të plotë të kredisë nga banka:

$$S = \sum_{l=1}^{m'} Rl\,(1+i)^{-tl}$$

S - është vlera totale faktike e kredisë (*total present value of drawdowns*) duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur për shembull, shpenzimet administrative etj.

Bankat duhet të sigurojnë që metodat e zgjidhjes së aplikueshme të japin një rezultat të barabartë me atë të shembujve të paraqitur në këtë aneks (shih më poshtë).

Shembuj:

I. Llogaritja e NEI- mbi baza kalendarike (1 vit=365 ditë ose 366 ditë për vitin e brishtë)

Shembulli 1:

Shuma e kredisë: 1000 euro, dhënë më 1 janar 1994. Kredia paguhet me një pagesë të vetme prej 1,200 eurosh në 1 korrik 1995 për shembull, 1.5 vjet ose 546 (365+181) ditë pas ditës së dhënies së kredisë.

Ekuacioni shndërrohet: $$1000 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{546}{365}}}$$

ose: $(1+i)^{546/365} = 1.2$

$1+ i=1.129624$

$i=0.1296204$

Kjo vlerë do të rumbullakoset në 13% (ose 12.96% nëse kërkohet saktësia me dy shifra dhjetore).

Shembulli 2:

Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative. Kështu, kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove, si edhe në shembullin e parë, bëhet në 1 korrik 1995.

Ekuacioni shndërrohet $$950 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{546}{365}}}$$

ose: $(1+i)^{546/365} = 1.263157$

$1+i=1.169026$

$i=0.169026$

kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9%

Shembulli 3:

Shuma e kredisë është 1000 euro, në 1 janar 1994, e ripagueshme në dy shuma, secila

prej 600 eurosh, e pagueshme respektivisht pas një dhe dy vitesh.

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{600}{(1+i)} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730}{365}}} = \frac{600}{(1+i)} + \frac{600}{(1+i)^2}$$

Zgjidhja e të cilit rezulton në i=0.1306623 të rrumbullakosur në 13.1 % (ose 13.07 nëse preferohet saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 4:

Shuma e kredisë është 1000 euro, e dhënë në datën 1 janar 1994 ndërsa shumat për t'u paguar nga kredimarrësi janë:

Pas 3 muajsh (0.25 vjetë/90 ditësh):	272 euro
Pas 6 muajsh (0.5 vjetësh/181 ditësh):	272 euro
Pas 12 muajsh (1 viti/356 ditësh):	544 euro
Totali:	1088 euro

Ekuacioni shndërrohet në:

$$1000 = \frac{272}{(1+i)^{\frac{90}{365}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{181}{365}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365}{365}}}$$

Rezultati i këtij ekuacioni është i =0.13226, e rrumbullakosur në 13.2% (ose 13.23% nëse kërkohet një saktësi në 2 shifra dhjetore).

II. Llogaritja e NEI në bazë të një viti standard (1 vit = 365 ditë ose 365.25 ditë, 52 javë ose 12 muaj të njëjtë)

Shembulli 1:

Shuma e kredisë: 1000 euro. Kredia do të paguhet me një pagesë të vetme prej 1200 eurosh pas 1.5 vitesh (për shembull, 1.5×365=547.5 ditësh, 1.5×12=18 muaj ose 1.5× 52=78 javë).

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.5}{365}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.875}{365.25}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{18}{12}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{78}{52}}}$$

ose: $(1+i)^{1.5} = 1.2$

1+i=1.129243
i= 0.129243

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 12.9 për qind (ose 12.92% nëse preferohet një saktësi në 2 shifra dhjetore).

Shembulli 2;

Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative, kështu që kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove, si dhe në shembullin e parë, bëhet 1.5 vjet pas marrjes së kredisë.

Ekuacioni shndërrohet:

$$950 = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.5}{365}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{547.875}{365.25}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{18}{12}}} = \frac{1200}{(1+i)^{\frac{78}{52}}}$$

ose:

$(1+i)^{1.5} = 1200/950 = 1.263157$

$1+i = 1.168526$

$i = 0.168526$

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9% (ose 16.85 nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 3:

Shuma e kredisë është 1000 euro, e ripagueshme në dy shuma, secila prej 600 eurosh, e pagueshme respektivisht pas një dhe dy vitesh.

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{600}{(1+i)^{\frac{365}{365}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730}{365}}} = \frac{600}{(1+i)^{\frac{365.25}{365.25}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{730.5}{365.25}}}$$
$$= \frac{600}{(1+i)^{\frac{12}{12}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{24}{12}}} = \frac{600}{(1+i)^{\frac{52}{52}}} + \frac{600}{(1+i)^{\frac{104}{52}}}$$
$$= \frac{600}{(1+i)^{1}} + \frac{600}{(1+i)^{2}}$$

nga ku i = 0.13066 e rrumbullakosur në 13.1% (ose 13.07 % nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

Shembulli 4:

Shuma e kredisë është 1000 euro dhe shumat për t'u paguar nga kredimarrësi janë:

Pas 3 muajsh (0.25 vjetë/13 javësh/91.25 ditësh/91.3125 ditësh):	272 euro
Pas 6 muajsh (0.5 vjetësh/26 javësh/182.5 ditësh/182.625 ditësh):	272 euro
Pas 12 muajsh (1 viti/52 javësh/365 ditësh/355.25 ditësh):	544 euro
Totali:	1088 euro

Ekuacioni shndërrohet:

$$1000 = \frac{272}{(1+i)^{\frac{91.25}{365}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{182.5}{365}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365}{365}}}$$

$$= \frac{272}{(1+i)^{\frac{91.3125}{365.25}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{182.625}{365.25}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{365.25}{365.25}}}$$

$$= \frac{272}{(1+i)^{\frac{3}{12}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{6}{12}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{12}{12}}}$$

$$= \frac{272}{(1+i)^{\frac{13}{52}}} + \frac{272}{(1+i)^{\frac{26}{52}}} + \frac{544}{(1+i)^{\frac{52}{52}}}$$

$$= \frac{272}{(1+i)^{0.25}} + \frac{272}{(1+i)^{0.5}} + \frac{544}{(1+i)^{1}}$$

Nga ku i = 0.13185 e rrumbullakosur në 13.2% (ose 13.19 % nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

ANEKSI NR.2

NJOFTIM PËR KOMISIONET E SHËRBIMIT ME KARTË

Klientë, kujdes!

1. Kjo ATM është e vendosur nga banka _____.

2. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në *cash*, duke përdorur kartën e debitit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision_____..

3. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni parate tuaja në cash duke përdorur kartën e kreditit (_____) të lëshuar nga banka jonë. Për këtë shërbim ju paguani një komision prej _____.

4. Në këtë ATM ju mund të tërhiqni paratë tuaja në cash edhe me karta të lëshuara nga banka të tjera, por në këto raste ju do të paguani edhe një komision për transaksionin që banka jonë do të kryejë me bankën, që ju ka lëshuar kartën.

5. Banka jonë nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nuk rimburson komisionet që ju do të

paguani për shërbimet e ofruara në këtë ATM, me karta të bankave të lëshuara nga banka të tjera.

6. Banka jonë është gjithnjë në shërbimin tuaj.

7. Për çdo problem dhe informacion të nevojshëm, lutem kontaktoni bankën tonë me këtë numër telefoni _____.